

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-050/13**

**Prishtinë,  
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të:

**D.F**

***Pala ankuese /Paraqitësja e kërkesës***

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/170/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin 24184), të datës 24 tetor 2012, pas seancës së mbajtur më 12 nëntor 2013, mori këtë

**AKTGJYKIM**

**1. Hedhet si e palejueshme ankesa e D.F, për shkak të mungesës së interesit juridik.**

**Përmbledhja e çështjeve procedurale:**

1. Më 7 shkurt 2007 N.S, paraqiti një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në emër të D.A.F, duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore për këtë të fundit mbi një ngastër tokë me sipërfaqe prej 0.14.35 ha në Vishe Selë, Miloshevë, Obiliq ngastra kadastrale nr. 590 (më tej: ngastra).
2. Në vendimin e vet të datës 24 tetor 2012 nr. KKPK/D/A/170/2012, KKPK vendosi se paraqitësja e kërkesës kishte vërtetuar pronësinë mbi ngastrën dhe e konsideroi kërkesën të bazuar.
3. D.A.F mori kopjet e vendimit më 12 shkurt 2013 dhe paraqiti ankesë kundër vendimit më 28 shkurt 2013. Kjo është brenda periudhës prej 30 ditësh të cekur në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.
4. Pasi që KKPK tashmë kishte vendosur plotësisht në dobi të palës ankuese, Gjykata Supreme dërgoi një urdhër të datës 29 korrik 2013 palës ankuese me qëllim që të shpjegohet cili është interesi i palës ankuese në këtë procedurë.
5. Gjykata Supreme u informua se ky urdhër iu dërgua palës ankuese më 12 gusht 2013. Më 19 tetor 2013, Gjykata Supreme u informua nga AKP se në atë datë nuk ishte pranuar asnjë përgjeje nga pala ankuese për këtë urdhër.

**Përmbledhja e çështjeve faktike:**

Kolegji i ankesave i merr si fakte të vërtetuara nga KKPK dhe të pakontestuar nga palët apo të dëshmuara të pavërteta këto:

6. Ngastra ishte e regjistruar në emër të C.D, nëna e ndjerë e N.S dhe motrave të saja S.D.A dhe D.A.F. Pas vdekjes së C.D në vitin 1987, ngastra është regjistruar në emër të vajzës më të madhe S.D.A.

7. S.D.A vdiq në vitin 2003. Me vendimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. 569/07 të datës 6 shkurt 2008, ngastra është regjistruar në emër të palës ankuese: D.A.F.
8. Humbja e aftësisë për t'i ushtruar të drejtat pronësore buron nga konflikti i armatosur në mes të shkurtit 1998 dhe qershorit 1999.
9. Pala ankuese është pronarja e ligjshme e ngastrës.

### **Arsyetimi ligjor:**

#### *Pozita e palës*

10. Gjykata Supreme prandaj e kupton ankesën e palës ankuese në këtë mënyrë ngase KKPK duket se ka gabuar për faktin se pala ankuese ka kërkuar të drejtën pronësorë mbi (më shumë se) 2 ha përfshirë një shtëpi, sipas fletave poseduese nr. 12 dhe 59. Megjithatë, vendimi i KKPK-së mbulon vetëm një sipërfaqe prej 0.14.35 ha.
11. Për më tepër, pala ankuese ka theksuar se KKPK ka dështuar të pranoj se ka palë kontestuese në kërkesën e palës ankuese. Pala ankuese thotë se që nga viti 2002, vëllezërit S., J., N., B., S. dhe H., kanë uzurpuar dhe në vitin 2010 kanë rrënuar shtëpinë. Kjo shtëpi është pjesë e kërkesës.

#### *Juridiksioni*

12. Kolegji i ankesave të Gjykatës Supreme ka juridiksion mbi këtë çështje.

#### *Pranueshmëria*

13. Sipas nenit 2.1 të Ligjit nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore, që zbatohet në procedurat para Kolegjit të Ankesave të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, një “*në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse*”. Prandaj, Gjykata Supreme duhet ta vërtetojë përmbajtjen e saktë të kërkesës fillestare.

14. Formulari i kërkesës, i paraqitur më 7 shkurt 2007 në AKP cek në faqen 3, në departamentin F të informatave mbi pronën e kërkuar. Këtu thotë se kërkesa ka të bëjë me ngastrën kadastrale nr.590, me sipërfaqe prej 0.14.35 ha në Vishe Selë, Milloshevë, Obiliq.
15. Bashkëngjitur kërkesës ndër dokumentet tjera është Fleta Poseduese nr. 12, nr 953-1/2009, e datës 24 qershor 2009 të komunës kadastrale Milloshevë. Kjo fletë poseduese përshkruan ngastrën 590 si një Pemishte e klasit të parë në Vish Sellë, me sipërfaqe prej 0.14.35 ha.
16. Skica e fletës poseduese nr.12 tregon se një shtëpi ishte pjesë e ngastrës 589, ku kjo ngastër nuk është pjesë e kësaj kërkesë por e kërkesave tjera të palës ankuese, të regjistruar si AKP 24178 dhe AKP 24182. Këto kërkesa me sa duket janë miratuar me vendimet e KKPK-së me numrat KKPK/D/A/186/2013 dhe KKPK/D/R/126/2011, të dyja të datës 13 shkurt 2013.
17. Sa i përket palës ankuese që dëshiron të theksojë se kërkesa fillestare mbulonte të gjithë pronën e cekur në fletën poseduese nr.59 të datës 3 shkurt 2007 (952-1/2007-190) dhe në fletën poseduese nr.12 të cekur më lartë, Gjykata Supreme nuk pajtohet me këtë. Për aq sa Gjykata Supreme ka mundur të vërtetojë, pala ankuese ka paraqitur kërkesa të ndara në AKP për ngastra të ndryshme të përmendura në të dyja fletat poseduese.

#### *Konkludim*

18. E lartcekura shpie në konkludimin se kërkesa e palës ankuese ka të bëjë vetëm me ngastrën e tokës me sipërfaqe prej 0.14.35 ha në Vishe Sellë, Milloshevë, Obiliq, ngastra kadastrale nr.590. Kjo është pikërisht ngastra për të cilën KKPK ka vendosur me vendimin e vet të datës 24 tetor 2012 nr. KKPK/D/A/170/2012 duke miratuar kërkesën në tërësi. Prandaj, pala ankuese nuk është e pranueshme në ankesën e saj pasi që ajo nuk ka interes ligjor sipas nenit 196 të LPK-ës..
19. Duke qenë kështu, Gjykata Supreme nuk ka nevojë t'i shqyrtojë çështjet tjera.

#### **Këshillë juridike**

20. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e kolegjit të EULEX-it**

**Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**